



GJURMIME ALBANOLOGJIKE

SERIA E SHKENCAVE HISTORIKE

48/ 2018

KRYEREDAKTOR
Prof. dr. Lulëzim Lajçi

REDAKSIA

Prof. dr. Xheladin Shala
Instituti Albanologjik-Prishtinë

Prof. dr. Muharrem Dezhgiu
Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Dr. Anton Panchev
Universiteti i Sofjes “Shën Kliment Ohridski”, Bullgaria

Prof. dr. Lulëzim Lajçi
Instituti Albanologjik-Prishtinë

Prof. dr. Naser Ferri
Instituti Albanologjik-Prishtinë

Prof. dr. Qerim Dalipi
Universiteti Shtetëror i Tetovës

SEKRETAR I REDAKSISË
Dr. Nuridin Ahmeti

<http://www.institutialbanologjik.com>
E-mail: institutialbanologjik@gmail.com

INSTITUTI ALBANOLOGJIK

GJURMIME ALBANOLOGJIKE

SERIA E SHKENCAVE HISTORIKE

48/2018

PRISHTINË

2018

INSTITUTE OF ALBANOLOGY

ALBANOLOGYCAL RESEARCHES

HISTORICAL SCIENCE SERIES

48/2018

PRISHTINA

2018

PASQYRA E LËNDËS – TABLE OF CONTENT

Punime studimore

Naser FERRI

PUSHTIMI I MBRETËRISË DARDANE DHE REZISTENCA
E DARDANËVE KUNDËR ROMAKËVE DHE ROMANIZIMIT.....9

Arben HAJDARI - Arianit BUQINCA -Milot BERISHA
FULGUR SACRUM - NJË EPITET I RI KUSHTUAR JUPITERIT
I ZBULUAR KOHËVE TË FUNDIT NË ULPANË.....29

Aleksandar ATANASOVSKI
KONSTANTINI I MADH DHE TRANZICIONI NGA HISTORIA
E EPOKËS ANTIKE NË ATË MESJETARE.....37

Emine KALAJA-HAJDARI - Premtim ALAJ
TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE NË KOMUNËN E DEÇANIT.....51

Ermal BAZE - Jaho CANA
TË DHËNA HISTORIKE RRETH FEUDALIZMIT
NË TROJET SHQIPTARE GJATË MESJETËS SË MESME
DHE TË VONË (SHEK. XI – XV).....57

Nuridin AHMETI
FIGURA E SKËNDERBEUT NË SHTYPIN FETAR SHQIPTAR
NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....67

Nehat KRASNIQI
SHPËRNGULJET E POPULLSISË SË KOSOVËS
GJATË LUFTËRAVE HABSBURGE – OSMANE.....79

Nail DRAGA LUFTA PËR TIVARIN SIPAS SPIRIDON GOPÇEVIQIT.....	95
Petr A. ISKENDEROV KRYENGRITJET E VITEVE 1908-1912 NË KONTEKSTIN E FORMIMIT TË SHTETËSISË SHQIPTARE.....	111
Sadik MEHMETI EKSPANSIONI ARSIMOR SERB NË KOSOVË NË FUND TË SHEK. XIX DHE NË FILLIM TË SHEK. XX.....	123
Izet MIFTARI BESIMI FETAR ORTODOKS DHE VOJVODËT (ROJTARËT) E KISHAVE DHE MANASTIREVE NË VILAJETIN E KOSOVËS (SHEKULLI XIX – 1912).....	133
Lush CULAJ VEPRIMTARIA E KOMITETIT TË KOSOVËS 1925-1939.....	149
Mustafë HAZIRI HULUMTIMET E PARA TË BRITANIKËVE NË MINIERËN E TREPÇËS NË STANTERG.....	163
Alban DOBRUNA GJAKOVA DHE KOMITETI MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS (1918-1924).....	181
Milazim ELSHANI SHPRESA PËR REALIZIMIN E SË DREJTËS HISTORIKE PËR BASHKIM KOMBËTAR – KONFERENCA E BUJANIT 74 VJET HISTORI.....	195
Haxhi ADEMI DISA TË DHËNA MBI ZHVILLIMIN E ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE.....	205
Memli SH. KRASNIQI PROPOZIMET E AKADEMIKUT DOBRICA QOSIQ MBI ZGJIDHJEN PËRFUNDIMTARE TË ÇËSHTJES SË KOSOVËS...217	217
Arbër HADRI PËRKRAHJA E SHBA NË RIMËKËMBJEN E KOSOVËS SË PASLUFTËS: QËNDRIMI AMERIKAN NDAJ ÇËSHTJES SË KOSOVËS 1999-2004.....	227

Lulzim NIKA ANGAZHIMI NDËRKOMBËTAR PËR KOSOVËN NË KËSHILLIN E SIGURIMIT TË OKB-SË GJATË VITIT 1998.....	243
Kosovar ALIJA - Fatlum IBRAHIMI RRETHANAT E ARDHJES DHE ROLI I PK-SË NË SHQIPËRI.....	255
Skender ZHITIA KOSOVA PËRBALLË GJENOCIDIT TË REGJIMIT SERB (1998-1999)...	267
Zeqirja REXHEPI REZISTENCA E ARMATOSUR E SHQIPTARËVE DHE PROPAGANDA E PUSHTUESIT SERB NË FUNDSHEKULLIN XX....	285

MATERIALE

Emine BAKALLI ÇËSHTJA E PUSHTIMIT DHE COPËTIMIT TË SHQIPËRISË (1939) NË KËNDVËSHTRIMIN E AUTORITETEVE USHTARAKE JUGOSLLAVE: DOKUMENTE.....	297
Ayten ARDEL AMBASADAT E HUAJA NË VILAJETIN E KOSOVËS GJATË SHEK. XIX-XX, SIPAS DOKUMENTEVE ARKIVORE OSMANE.....	319
Nuridin AHMETI MARRËDHËNIET MIDIS KOSOVËS DHE SHQIPËRISË MË 1974 - Sipas një Raport-programi sekret të mr. Ukshin Hotit.....	329
Arbër HADRI BURIMET HISTORIKE TË SHBA LIDHUR ME POLITIKËN E JASHTME AMERIKANE NDAJ ÇËSHTJES SHQIPTARE: PJESA E PARË E SHEKULLIT XX.....	349

RECENSIONE

GJURMËT E PERANDORIT AUGUST NË HISTORINË E ILIRISË

The century of the brave, Roman conquest and indigenous resistance in Illyricum during the time of Augustus and his heirs -Stoljeće Hrabrih-Rimsko osvajanje i otpor starosjedilaca u Iliriku za vrijeme Augusta i njegovih nasljednika, Proceedings of the international conference Zagreb, 22-26. 9. 2014, Edited by Marina Milićević-Bradač and Dino Demicheli, Department of Archaeology, Faculty of

Humanities and Social Sciences, University of Zagreb 2018, 422 f. /Naser Ferri/.....	357
Gjokë DABAJ, E kaluara e vërtetë e Arqipeshkvisë së Tivarit, Botoi: ART CLUB, Ulqin 2014. /Dr. Nail Draga/.....	361
Memli KRASNIQI, <i>Shqiptarët në shtypin britanik (1774-1856)</i> , Prishtinë 2017 /Prof. dr. Pëllumb XHUFU/.....	365
FERIT PASHË VLORA - I FUNDMIT VEZIR I MADH SHQIPTAR I PERANDORISË OSMANE	
(Abdulhamit KIRMIZI, <i>Ferid Pashë Vlora - një jetë shtet</i> , (përktheu: Rubin Hoxha), “Logos-A”, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2018, f. 542). /Nuridin AHMETI/.....	371
“Mid’hat Frashëri-Veptra të zgjedhura, Vëllimi 2”, përgatitur : Dr. Uran Butka, Tiranë: Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, 2018 /Memli Krasniqi/.....	375
DRITË E RE MBI TARIKATIN HALVETI NË TROJET SHQIPTARE	
Alban DOBRUNA, <i>Tarikati islam Halveti te shqiptarët</i> , Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2017, 416 f./Naser Ferri/.....	379
Sulltane KOJÇINI-UKAJ, <i>Zhvillimi i arsimit në Kosovë 1945-1952</i> , Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2006, f.268. /Kosovar Basha/.....	383
DITAR I LUFTËS SË LAVDISHME	
Dr. sc. Milazim ELSHANI, “ <i>Betejat e lavdishme të Brigadës 123</i> ”, Ditar lufte, Shoqata e historianëve “Hasan Prishtina”, Suharekë, BAF, Prizren, faqe 172. /Prof. dr. Daut Bislimi/.....	385
Lekë Pervizi, “ <i>Gjenerali- jeta e veprimtaria e atdhetarit të shquar gjeneral Prenk Previzi</i> ”, Bruksel, 2016, 274 faqe./Milazim Elshani/.....	391
NJË VEPËR ME INTERES SHKENCOR PËR NJOHJEN E POZITËS SË SHQIPTARËVE NË MAQEDONI (1944-1974)	
(“ <i>Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë - 1944-1974</i> (Përmbledhje dokumentesh), vëll. I-VI, përgatitur nga Dr. Qerim Lita”, Sh. B. “LOGOS-A”, Shkup, 2018, f. 3000) /Sadik Mehmeti/.....	397
KRONIKA SHKENCORE	
KRONIKË SHKENCORE E AKTIVITETEVE TË INSTITUTIT ALBANOLOGJIK - DEGA E HISTORISË PËR VITIN 2018 Nuridin AHMETI – Arianit BUQINCA.....	403

KONSTANTINI I MADH DHE TRANZICIONI NGA HISTORIA E EPOKËS ANTIKE NË ATË MESJETARE

Aleksandar ATANASOVSKI
Fakulteti Filozofik - Shkup
Instituti i Historisë

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër:Ky punim thekson rëndësinë e një altari kushtuar Jupiterit *Sacrum*, i zbuluar në Ulpianë në afërsi të murit lindor fortifikues të qytetit. Të dhënat epigrafike të ruajtura në altar shprehin qartazi praninë e kultit të *Jupiter Fulgur* në Ulpianë. Bazuar në të dhënat paleografike dhe analogjitë me monumente të ngjashme në provincat e Danubit, si dhe duke marrë për bazë kontekstin historik të vendit të zbulimit, një datim i përafërt i altarit mund të propozohet në shekujt II-III. Prezenca e epitetit *Fulgur* deri tani ka qenë e panjohur në mbishkrimet e zbuluara në territorin e Ulpianës, prandaj, me këtë epitete, Jupiteri është dëshmuar për herë të parë në Ulpianë, por edhe në Kosovë. Përdërisa nën kualifikimin e shenjtë *sacrum*, Jupiteri është dëshmuar edhe me parë në përkushtimet dedikuara kultit të tij në Kosovë. Zbulimi i altarit kushtuar *Jupiter Fulgur* në Ulpianë vetëm sa e konfirmon faktin se Jupiteri adhurohej dhe nderohej gjerësisht në mesin e banorëve të këtij qyteti. Kështu, paraqitja e tij me epitetein *Fulgur*, vetëm sa e plotëson korpusin e epiteteve me të cilat adhurohej dhe nderohej kulti i tij në qytetin e Ulpianës.

Konstantini i Madh, perandorinjtë të Romës, iu deshën vetëm pesëmbëdhjetë vjet për t'i realizuar dy akte që ndryshuan fatin e gjithë botës së qytetëruar. Akti i parë kishte të bënte me tolerancën ndaj krishterimit që, vetëm një gjeneratë para tij, kishte qenë objekt i përjashtimit zyrtar, më brutal se sa ndaj kulteve tjera fetare në Perandorinë Romake para apo pas kësaj periudhe. Akti i dytë kishte të bënte me zhvendosjen e kryeqendrës së perandorisë së tij, nga Roma në një qytet të ri, që ishte duke u ndërtuar në hapësirën e Bi-

zantit, e që gjatë njëmbëdhjetë shekujve të ardhshëm do të quhej qyteti i Konstantinit, Kostandinopoja. Këto dy akte dhe pasojat që rrodhën nga to, i japin atij të drejtën të quhet personi me ndikimin më të madh në histori. Kjo është arsyeja kryesore që ky artikull i dedikohet atij.

Supozohet se ai lindi në Nish, në provincën romake të Dakisë, tani qytet në Serbi, më 27 shkurt, por askush nuk mund ta përcaktojë saktë vitin e tij të lindjes. Ai mund të ketë lindur në vitin 274, por mund të ketë qenë edhe një apo dy vite para apo pas kësaj date. Babai i tij ishte Konstantiusi, të cilin e quajmë Chlorus, që do të thotë “i zbehur”. Në kohën e lindjes së të birit të tij, ai kishte qenë njëri nga komandantët më të shquar romakë. Kur i biri i saj mori pushtetin mbi perandorinë, nëna e tij, Helena, u shndërrua në gruan më të adhuruar në perandori.¹ Pavarësisht vitit kur kishte lindur, Konstantini me siguri kishte qenë fëmijë kur babai i tij ishte bërë njëri nga katër sundimtarët e Perandorisë Romake. Më parë, më 286, perandori Dioklecian kishte ardhur në përfundim se perandoria tanimë ishte bërë tepër e madhe për ta sunduar i vetëm, armiqtë e tij ishin të shumtë, kurse mënyrat e komunikimit ishin tepër të ngadalta. Pasi që kishte shumë punë për një sundimtar të vetëm, ai e ftoi Maksimianin, një bashkëluftëtar të vjetër, për ta ndarë fronin. Ai vetë, duke qenë gjithmonë i interesuar për sferën lindore, u vendos në Nikomedia, në brigjet e detit Marmara, një vend që barabarësisht ishte larg nga lumenjtë Danub dhe Euftrat. Nën rrethanat e favorshme që pasuan sundimin e tij, Nikomedia u rrit në një shkallë të tillë sa të krahasohej me Antakjan, Aleksandrinë, madje edhe me Romën. Megjithatë, Roma, gjatë epokës së Dioklecianit kishte pak gjëra për të cilat mund të vlerësohej, në përjashtim të zbehjes së madhështisë së vjetër. Pozita e saj gjeografike i jepte të drejtën të konsiderohej si një kryeqytet modest perandorak gjatë shekullit të tretë. Kur Maksimiani u ngjiti në fronin perëndimor, ishte plotësisht e arsyeshme të perceptohej se ai do ta sundonte Mediolan (Milanon).

Dy perandorë ishin më mirë se sa një, por nuk kaloi një kohë e gjatë dhe Diokleciani vendosi që ta ndante pushtetin e perandorit, duke emëruar dy cezarë. Këta dy komandantë ushtarakë, pavarësisht se i nënshtroheshin atij dhe Maksimianit (me të cilin kishte ndarë edhe titullin August), duhej ta ushtronin pushtetin suprem në regjionet periferike; me kalimin e kohës ata do ta fitonin status më të lartë. Njëri nga këta cezarë të parë, një ushtar profesionist i rreptë dhe i vrazhdë, që ishte nga Trakia, i quajtur Galerius, mori përsipër

¹ PG 87, 4061C-4064A, Sipas: Жан-КлодШене, БернарФлизен, Византија. Историја и цивилизација. CLIO, Београд 2010, 243. *Atanasovski, Al. “The Night as a Motive in ByzantineHistoryandPolitics.” Paperpresented at Internal seminar “Balkans by Night” 19-21 ofapril 2012, Blagoevgrad, Bulgaria*

sundimin në Ballkan. I dyti, i cili duhej të qëndronte në Galí, i ngarkuar me detyrën e veçantë të rivendosjes së pushtetit romak në Britani, ishte Konstantius Chlorusi.

Pasojat e një organizimi të tillë duhej të kishin qenë të qarta qysh atëherë. Ndonëse Diokleciani bëri përpjekje të mëdha për ta ruajtur unitetin dhe integritetin e perandorisë përmes një ligji dhe strukture qeverisëse, ishte e pashmangshme që herët a vonë, në vend të një perandorie, ai dhe pasuesit e tij do të jenë dëshmitarë të katër perandorive, secila prej tyre me tendenca të ushtrimit të superioritetit ndaj të tjerave. Dhe kjo ishte ajo se çfarë saktësisht ndodhi. Ndonjëherë çdo gjë shkonte sipas planeve. Kjo ishte periudha kur Konstantini po jetonte në oborrin e Dioklecianit, ndoshta në cilësinë e një pengu me qëllim të ofrimit të garancisë se ai ishte i denjë për sjelljet e babait të tij (duke qenë i ndryshëm nga katër tetrarkët tjerë dhe që nuk u besonte të tjerëve). Sidoqoftë, ai ishte një anëtar i shquar i suitës perandorake.

Në këtë kapacitet perandori e shoqëroi atë në fushatën ushtarake në Egjipt gjatë viteve 295-296, duke arritur në Palestinë përmes qytetit Caesares, ku, siç mund të lexojmë, ai i bëri një përshtypje të fuqishme teologut të ri të krishterë, Euzebiusit. Në vitet e tij të vonshme, Euzebius do të veprojë si një peshkop lokal dhe do të bëhet biografi i parë i Konstantinit. Ai ishte vetëm tridhjetë vjeç kur për herë të parë e takoi Konstantinin, duke qenë ende mik, student dhe besnik ndaj Pamfiliusit, i cili ishte një mbrojtës i shquar i shkollës origjinale teologjike që ishte e famshme në kohën e Cezarit.² Në veprën e tij, *Vita Constantini* (Jeta e Konstantinit), ai jepte këtë përshkrim: “Me një fizik të bukur dhe i gjatë aq sa mos të mund të krahasoheshin të tjerët me të, me fuqi fizike që i tejkalonte bashkëkohësit e tij, madje duke futur frikë tek ata; krenaria e tij veçohet më tepër në vlerat morale se sa në superioritetin e tij fizik, duke fisnikëruar shpirtin para së gjithash me një vetëpërmbytje, për t’u shquar më pas me përsosmërinë e edukimit të tij retorik, mendjemprehtësisë instiktive dhe me urtësinë që ia kishte dhuruar Zoti”.³

Dy vite më vonë, Konstantinin do ta shohim gjatë një fushate si një dorë e djathtë e shefit të tij, kësaj radhe kundër persëve dhe në kuadër të faktit se gjatë këtyre viteve ai rrallë herë ishte larg Dioklecianit, supozohet se në vitin 303 ai ishte dëshmitar i një djegieje të qëllimshme të një kishe të sapo

² Успенски, Ф., Историја Византијског царства од 6. до 9. Века. Предео Зоран Буљугић, Београд 2000, 75.

³ Eusebius, *Life of Constantine*, Introduction, edition and translation by A. Cameron and St. G. Hall. Oxford, 1999, p. 77. Shih: Eusebii Pamphili, *Vita Constantini et Panegyricus eius que Constantini ad sanctorum coetum oratio*. Lipsiae, Hermann Medelssohn MDCCC-LXIX, I, 19.

ndërtuar të krishtere në Nikomedia si dhe të ballafaqimeve dramatike të kishave të ndaluara, që mezi kontrolloheshin dhe të cilat do ta shprehnin tërbimin e tyre gjatë tetë viteve të ardhshme.⁴ Megjithatë, në vitin 305 ndodhi një ngjarje e paprecedentë në historinë e Perandorisë Romake: abdikimi vullnetar i një perandori nga pushteti. Pas njëzet vitesh të qëndrimit në fronin perandorak, Diokleciani dha dorëheqje dhe vazhdoi të jetojë pa vënë re në pallatin që e ndërtoi për vete në brigjet dalmate të qytetit Salona (Spliti i sotëm), duke e detyruar edhe Maksimianin që të abdikonte njëkohësisht. Pozitat e tyre u plotësuan nga cezarët e mëhershëm si Galeriusi dhe Konstantius Chlorusi, por kjo zgjedhje e cezarëve të rinj u reflektua si një proces tejet dramatik. Konstantini iku nga Nikomedia dhe shkoi në Bolonja, nga ku së bashku me babanë e tij, ndërmori një fushatë në Britani. Babë e bir kaluan kanalin anglez dhe pas gjitha zhvillimeve një qasje mashtruese doli të jetë e suksesshme. Jo larg pas kësaj ngjarjeje, më 25 korrik 306, Konstantius Chlorus vdiq në York, kurse miku dhe aleati i tij, mbreti Crocus i Alemanit, i cili i komandonte trupat mbështetëse, e shpalli Konstantinin si një August dhe pasues të babait të tij. Më pas, po në të njëjtin vend, supet e tija veshën xhyben mbretërore, atë e bartën dhe e ulën në fron, kurse ai qau deri në shterim.

Kjo ishte një fitore vendimtare për karrierën e Konstantinit, në provincën e Galisë, një provincë që u zotua për besnikëri dhe që mbështeti komandantin e ri të ushtrisë. Gjatë gjashtë viteve të ardhshme Konstantini qëndroi në Gali dhe Britani. Në vitin 307 ai braktisi bashkëshorten e tij të parë dhe u martua me të bijën e Maksimianit, Faustën. Maksimiani, qysh para dy vitesh e kishte tërhequr abdikimin dhe së bashku me të birin Maksentiusin, pushtoi gjithë Italinë, Spanjën dhe Afrikën Veriore. Megjithatë, situata ishte ende e paqartë, pasi që ata do të mund të sulmoheshin në emër të Galeriusit dhe nëse Konstantini gjatë kësaj periudhe do të drejtohej kundër tyre, fati i tyre do të mund të kishte qenë i errët. Martesa, në aspekt diplomatik, ishte e favorshme për dyja palët.

Në vitin 311 Galeriusi vdiq.⁵ Vdekja e Galeriusit bëri që treshja ta ndajë pushtetin suprem: tre vite më parë, Valerius Licinianus, i quajtur Licinius, njëri nga miqtë e vjetër të pijes së perandorit të ndjerë, mori pozitën e bashkë-Augustit, dhe vendosi sundimin e tij në provincat e Ilirisë, Trakisë dhe Danubit; Maksiminus Daya, nipi i tij, ishte zgjedhur cezar më 305 dhe kishte vendosur kontrollin mbi pjesën lindore të perandorisë, njëjtë sikurse Konstantini. Megjithatë, ekzistonte edhe personi i katërt, i cili, ndonëse ishte bartës jozyrtar i titullit perandorak, qysh prej kohësh besonte se kishte diçka që i

⁴ Për më tepër shih: Ф. Успенски, *Историја*, 75-76.

⁵ Për më tepër mbi vdekjen e tij shih: Evsevij, *Historia Ecclesiastica*, VIII, 16.

takonte atij. E ky ishte dhëndri i Galerius Maksentiusit – i biri i Maksimianit të ndjerë, përndryshe armik i kunatit të tij, Konstantinit.

Çështja lidhur me trashëgiminë duhej zgjidhur përmes luftës. Gjatë përgatitjeve për luftë, Konstantini lidhi aleancë me Liciniusin. Aleanca u vërtetua përmes një martese - kësaj radhe Liciniusi martoi të motrën e Konstantinit, Konstantën. Përgatitjet filluan në vitin 311 për të vazhduar me fushatë në vitin 312. Ishte një fakt i njohur se Konstantini në mënyrë të suksesshme u fut në Itali, kurse ideja e Maksentiusit për të qëndruar në Romë u arsyetua në pikëpamje strategjike.

Ushtritë e dy palëve u ballafaquan më 28 tetor 312 afër vendit Saxa Rubra tek Via Flamini, rreth dhjetë kilometra në verilindje të Romës, aty ku lumi Kremera derdhet në lumin Tiber dhe në të njëjtin vend, në bazë të legjendës së vjetër, para apo gjatë betejës, Konstantini përjetoi popullaritetin e personalitetit të tij. Euzebio e përshkroi në këtë mënyrë: “Ky filloi të lutet tek perëndia, të lutet dhe të kërkojë që të dëshmohet se kush ishte ai, lutej që t’i shtrihej dora e djathtë për t’i ndihmuar në planet e tij. Pasi i kreu këto lutje të sinqerta, perandorit iu shfaq shenja më e qartë nga perëndia. Nëse dikush tjetër do ta theksonte këtë, me siguri nuk do të ishte e lehtë që të pranohej; por pasi që vetë perandori fitimtar personalisht pas një kohe të gjatë i rrëfeu ngjarjen shkrimtarit në fjalë, kur shkrimtari ishte i privilegjuar me njohjen dhe shoqërimin me të, dhe kur ai i kishte vërtetuar thëniet përmes betimit, kush do të mund të mos e besonte rrëfimin, në veçanti kur rrethanat pasuese ofruan dëshmi për të vërtetën e thënë? Lidhur me diellin e mesditës, kur dita shkonte drejt perëndimit, ai tha se me sytë e tij kishte parë lart në qiell dhe duke qëndruar mbi diell, një trofe në formë kryqi të formuar nga drita dhe një tekst pranë ku thuhej: “Në këtë shenjë, fiton”. Spektakli mahnitës pushtoi atë dhe gjithë ushtarët të cilët më pas e shoqëruan atë në një fushatë, duke dëshmuar për mrekullinë”⁶.

I gjallëruar me një shenjë dhe vullnet të tillë nga perëndia, Konstantini e mposhti Maksentiusin, duke e lënë atë në vendin ku lumi Tiber bënte një kthesë të madhe pranë urës Milvian. Maksentiusi, pranë urës së vjetër menjëherë ndërtoi një urë të re – mbi pontone – përmes së cilave, po të kishte nevojë që t’i printe ushtrisë. Këtë do ta bënte duke mos i shpërndarë radhët, kurse ura do të shkatërrohej në mënyrë që armiku mos mund ta përdorte. Ushtria e Maksentiusit kaloi mbi urën në fjalë, e cila po vëzhgohej nga ushtarët e Konstantinit. Ushtria, apo ajo çfarë mbeti nga ajo, do të mund të kursehej nëse inxhinierët e Maksentiusit nuk do ta humbnin kontrollin mbi

⁶ Eusebius, *Life of Constantine*, I, 28. See also: Тъпкова-Заимова В., Димитров Д., Павлов П., Византия и византийският свят. София 2011, 19.

urën me ponton; në këtë mënyrë ushtarët nuk do të përmytheshin në lumin Tiber. Pjesa tjetër e ushtrisë ishte grumbulluar mbi urën e vjetër, që ishte tepër e ngushtë që t'i zinte gjithë ata. Me ta ishte edhe uzurpatori Maksentius. Shumë prej tyre ranë në lumë, përfshirë edhe Maksentiusin. Trupi i tij u zbulua më vonë, kur lumi e kishte hedhur atë në breg.⁷ Kjo betejë e bëri Konstantinin sundimtar të të gjithë Perandorisë Romake, që nga oqeani Atlantik e deri në detin Adriatik dhe që nga Muri i Hadrianit e deri tek malet Atlas. Për më tepër, beteja ishte një shenjë, nëse jo për konvertimin e tij të plotë në krishterim, atëherë së paku për epokën kur ai u bë një mbrojtës dhe zotërues i nënshtetasve të tij të krishterë.

Në kulmin e përpjekjeve për unifikimin e Perandorisë, në vitin 313 në Milano, perandorët Konstantini dhe Licinius e promovuan Ediktin e famshëm të Milanos⁸, i njohur si edikti i tolerancës fetare, që njihte barazinë e gjitha religjioneve përfshirë edhe krishterimin. Politika e re fetare mund të sqarohet jo vetëm nga rrethanat e përgjithshme, por edhe nga ndryshimet që vetë Konstantini i përjetoi. Në të vërtetë, duke përjetuar parafytyrimin e kryqit, Konstantini nxitoi që ta pranonte krishterimin. Klerit të krishterë iu akorduan privilegje shtesë. Ai filloi me ndërtimin e kishave jo vetëm në Romë, por edhe në çdo vend të perandorisë. Në vitin 325 ai thirri Këshillin Ekumenik në Nikea, ku u përcaktua simboli i besimit. Para kësaj, në vitin 319 Konstatini i Madh i akordoi kishës të drejtën e juridiksionit, që do të thotë se ai, themeloi Gjykatën Kishtare e cila do të mund t'i shqyrtonte rastet nëse besimtarët do ta kërkonin një gjë të tillë. Sipas Euzebius Cezareas, perandori u baptizua 50 ditë para vdekjes së tij, më 21 maj 337.⁹ Konstantini i Madh ishte i vetmi perandor i kanonizuar nga kisha. Ai ishte shpallur si “i barabartë me apostujt” si rezultat i punës së tij në aspekt botëror e historik.¹⁰

Se deri në çfarë shkalle shkonte parafytyrimi lidhur me kryqin për të cilin perandori pohonte se e kishte parë në urën Milvian, paraqitet jo vetëm si një hap vendimtar në jetën e tij, por edhe në kuptimin e rrjedhøjave – çast vendimtar në historinë botërore. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje duhet që

⁷ Eusebius, *Life of Constantine*, I, 26-36; Успенски Ф., Историја Византијског царства Т 1, 78-79; Dž. Norič, *Vizantijarani vekovi*. Përktheu nga gjuha angleze: P. Urošević, Beograd 2009, 40-41. Beteja u zhvillua më 28 tetor 312. Shih: Тъпкова-Заимова В., Димитров Д., Павлов П., Византия, 19.

⁸ Për më tepër mbi Ediktin e Milanit, shih: Коев Т.,-Бакалов Г., Въведение въхристиянството, София 1992,55-57; Успенски Ф., Историја Византијског царства, т. 1, Београд, 2000, 79-80.

⁹ Eusebii Pamphili, *Vita Constantini*, IV,61, p.184-185.

¹⁰ Eusebii Pamphili, *Vita Constantini*, IV, 60, p. 183; Тъпкова-Заимова В., Димитров Д., Павлов П., Византия и византијският свят.19.

patjetër të përmendet një gjë: çfarë ndodhi në realitet? Versioni më i vjetër i rrëfimeve që përmenden, nga rrethi i dytë i burimeve për këtë periudhë, vjen nga dijetari i krishterë Laktantiusi, i cili, që nga momenti që i shpëtoi persekutimit (apo rreth kësaj periudhe), u emërua nga Konstantini si mësues i të birit të tij, Crispusit. Nuk është aq me rëndësi nëse ai ishte apo nuk ishte pjesëtar i suitës perandorake, por esenca qëndron nëse pas një kohe të shkurtër Laktantiusi e kishte mundësinë që personalisht ta pyeste perandorin se çfarë kishte ndodhur me të vërtetë.¹¹ Pas një kohe të shkurtër u bë e njohur se çfarë kishte çuar në vendosjen e kryqit (XP) në mburojat e ushtarëve.¹²

Prandaj, nuk ekziston asnjë fjalë tjetër për ngjarjen e fundit! Këtu nuk përmendet asgjë për parafytyrimin, por vetëm për ëndrrën. Nuk ka informacione mbi shkrimtarin e inspiruar të krishterë, sipas të cilit shpëtimtari apo kryqi iu paraqit perandorit. Lidhur me paraqitjen e “shenjës hyjnore”, ishte vetëm një monogram që përmbante shkronjat X dhe P, dy shkronjat e para greke për emrin e Krishtit, shkronja që njihen të përdorura si simbole në shënimet e krishtere qysh prej një kohe të gjatë. Me siguri, një fakt tjetër i njohur është se Euzebiusi nuk e ka përmendur as ëndrrën e as parafytyrimin në përshkrimin e tij mbi betejën, e cila jepet në “historinë kishtare” rreth vitit 325.¹³ Vetëm në punimin e tij “Jeta e Konstantinit”, shkruar shumë vite pas vdekjes së perandorit, ai i shkroi rreshtat e cekura më lart dhe i përhapi ato së bashku me versionin e plotë të rrëfimit të Laktantiusit, që shfaqet një natë pas parafytyrimit të Krishtit, i cili perandorit i paraqitet në ëndërr. Krishti i kishte thënë atij që ta bënte emblemën e flamujve dhe të mburojave ngjashëm me shenjën që ai e kishte parë në qiell dhe të njëjtat t’i përdorte në gjitha betejat si një mbrojtje kundër armiqve të tij. Ky veprim, thotë Euzebiusi, ishte ndërmarr nga Konstantini që të nesërmen. Rezultati i kësaj embleme (shenje) të njohur si *labarum*¹⁴ përbëhej nga një kryq i shoqëruar nga një shtizë e artë e dekoruar, në maje të së cilës qëndronte një kurorë lulesh dafine që rrethonin monogramin e shenjtë. Kur Euzebiusi e kishte parë atë pas disa vitesh – portretin e artë të perandorit dhe të fëmijëve të tij – ai kishte mbetur jashtëzakonisht i befusuar.

¹¹ Lucii Caecilii Firmiani Lactantii, *De mortibus persecutorum. Cum Notis Strphani Baluzii. Editiosecundu*, MDCXCIII, XLIV, p. 96. (Natamuskратно: Laktancije, *De Mortibus persecutorum*); Eusebii Pamphili, *Vita Constantini*, I, 29, 37 p. 29-30.

¹² Laktancije, *De Mortibus persecutorum*, XLIV, p. 96-97.

¹³ Eusebii Pamphili, *Historiae ecclesiasticae. Libri X*, Lipsiae, Herman Mendelssohn, MDCCCLXVIII, 498-500.

¹⁴ Eusebii Pamphili, *Vita Constantini*, I, 29, 37 p. 29-30.

Duke i marrë parasysh të gjitha, mund të arrihet përfundimi se ky parafytyrim i kryqit mbi fushën e betejës, përshkrimi i një përfytyrimi të tillë pa ndërprerje gjendet në pikturat dhe freskat e kishave dhe galerive të artit në Perëndim, në të vërtetë nuk kishte ndodhur kurrë. Nëse do të kishte ndodhur, do të ishte e pakapshme që mos të kishte dëshmi në të dhënat historike të kohës, përfshirë edhe veprën “Jeta e Konstantinit”. Duket se perandori nuk kishte deklaruar diçka të tillë deri në kohën e vdekjes së tij, kur e kishte takuar Euzebius, e as në rastet kur një gjë e tillë mund të pritej prej tij. Një kohë të shkurtër pas vdekjes së tij, mund të shihet se si peshkopi Kiril i Jerusalemit e garantonte Konstantinin II se parafytyrimi i kryqit në qiell përmes rrugëtimit të shumë meteorëve¹⁵ ishte një shenjë shumë më hyjnore se sa vetë kryqi që ishte gjetur nga gjyshja e tij Helena në Tokën e Shenjtë – ndoshta peshkopi mund të kishte harruar për ta përmendur parafytyrimin e Konstantinit, nëse do kishte njohuri për të. Këtu kemi një theks të veçantë mbi Euzebius se “e gjithë ushtria ishte dëshmitare e kësaj mrekullie”.¹⁶ Nëse kjo do të ishte e vërtetë, atëherë si është e mundur që 98000 ushtarë në mënyrë të suksesshme ta ruajnë këtë sekret në vete?

Në anën tjetër, ekziston shumë pak hapësirë për të besuar se mu para betejës vendimtare, perandori kishte përjetuar një joshje të fuqishme shpirtërore. Raporti i detajuar i Laktaniusit mund të jetë i saktë, por përvoja të ngjashme zakonisht nuk ndodhin në fenomene të tilla lehtësisht të përshkruese sikurse janë ëndrrat. Ekzistojnë sinjale se Konstantini ishte në situata të pasigurisë serioze, pasi që dy vite më herët ai kishte urdhëruar vrasjen e vjehrrit të tij – Maksimilianit dhe ai gjithnjë e më tepër ishte i prirë drejt monoteizmit. Pas vitit 310, në monedhat e tij metalike, në vend të zotave të vjetër romakë, qëndronte vetëm një zot – Heliosi, apo siç ishte e njohur si Sol Invictus – i Biri i Pathyeshëm, për të cilin Konstantini po ashtu kishte pohuar ta kishte pasur një parafytyrim disa vite më parë, derisa ishte duke luftuar në Gali. Sidoqoftë, ky besim tanimë ishte tepër i favorizuar dhe gjerësisht i përhapur në gjithë perandorinë, por kjo duket se nuk e kishte kënaqur atë, kështu që Euzebiusi rrëfen për udhëtimin e Konstantinit në Itali, i vetëdijshëm se së shpejti atje do të zhvillohej një betejë e rëndësishme për jetë, betejë që do ta përcaktonte ardhmërinë e tij të plotë dhe se ai përpiqej për zbulimin e hyjnisë. Shkurt, nuk ishte askush më i përgatitur se sa Konstantini që të konvertohej gjatë verës së vonshme të vitit 312 dhe nuk ishte befafuesë që lutjet e tij u dëgjuan.

¹⁵Eusebii Pamphili, Vita Constantini, I, 31, p. 30.

¹⁶Eusebii Pamphili, Vita Constantini, 28.

Nëse e pranojmë këtë hipotezë, atëherë rrëfimi i Euzebiusit bëhet edhe më i kuptueshëm. Kjo pasi që në një këndvështrim i tillë është më pak shtrembërues dhe më tepër një ekzagjerim i pandërgjegjshëm, sidomos pas betejës në urën Milvian, ku Konstantini ushqeui ndjenja më të zhvilluara se ai ishte i ngarkuar me një mision të shenjtë. Përgjatë viteve kjo ndjenjë depërtoi tek të gjithë. Periudha në të cilën jetoi ai, lejonte paraqitjen e përgjithshme të shenjave dhe të mrekullive hyjnore dhe mjaftonte vetëm një hap i vogël për të menduar se kishte pasur një parafytyrim, dhe nëse i marrim parasysh rrethanat (kushtet), besimi për ekzistencën e parafytyrimit ishte i mundshëm. Euzebiusi është personi i fundit që mund të kishte bërë një ekzaminim të përgjithshëm. Ai, thjeshtësisht përshtati rrëfimin e tregimit dhe parafytyrimin dhe në këtë mënyrë u ofroi pasuesve të tij materialin, të njëjtën ndjenjë për ta përdorur atë si një “providencë hyjnore”. Në këtë mënyrë, fuqisë së perandorit iu dha një origjinë hyjnore. Ky rrëfim pothuaj u përvetësua tërësisht nga Theofani – Rrëfimtari.¹⁷ Euzebiusi pohoi se parafytyrimi i Konstantinit zuri vend në testimin nga ushtarët, por ëndrra nuk ofronte ndonjë dëshmi, sepse ajo (ëndrra) ka fuqi mistike dhe nuk është selektive, por individuale dhe duke pasur parasysh vetëm fuqinë mistike të ëndrrës, Euzebiusi e inkorporoi atë në rrëfimin e tij në mënyrë që lexuesit ta kuptojnë arsyen e Konstantinit për ta ndërmarrë një hap të tillë. Në fakt, ekziston edhe baza themelore se fuqia ishte mistike, kurse supremi dhe perandori ishin nën mbrojtjen e Zotit. Kjo ideologji do të jetë baza e konceptit të shtetit të ardhshëm bizantin lidhur me origjinën e autoriteteve dhe kredencialeve të perandorit.

Në të kaluarën ekzistonte kulti i Perandorit. Por, me pranimin e krishterimit si një religjion shtetëror ndryshoi edhe mendimi i përgjithshëm që u shoqërua me një perceptim të ri ndaj perandorit, i cili tanimë nuk ishte perëndi e as i thirrur nga perëndia.¹⁸ Megjithatë, nuk duhet menduar se befasisht u ndërpreu edhe traditat e vjetra. Përkundrazi, edhe në kohën e sundimtarëve të krishterë në Bizant kishte paraqitje të kulteve të vjetra perandorake romake, si p.sh. imazhet perandorake qëndronin ende të varura në zyrat administrative të dioqezave, etj. Këto imazhe kishin një karakter të pastër politik: njohjen e subjekteve të perandorit, të cilat në këtë mënyrë, i premtuan atij angazhim të pakufishëm. Shkrimtarët e krishterë sqaruan se një fenomen i tillë nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me personalitetin e perandorit; ata ishin të orientuar drejt gjitha simboleve të krishtera që perandori i posedonte, duke theksuar se ai, si një subjekt mortor, nuk gëzon të drejtën që të jetë objekt i aq

¹⁷ Theophanis, Chronographia. Ex recensione Ioannis Classeni. Volumen I. Bonnae, MDCCCXXXIX, 19, p. 11.

¹⁸ Караянопулос, Й. Е., Политическа татеорияна Византийците, София 1992, 19.

shumë ndereve. “Kur përkulemi, aty shihet kulti i kryqit të krishterë para perandorit. Krahas kësaj qëndron edhe vizioni i Konstantinit ku ai kishte dëshiruar që të konsiderohej si “njëri nga skllëverit e perëndisë”.¹⁹ Këto fakte ishin një arsye për ideologjinë e krishtere që idenë “autokrat-perëndi” ta transformojë në “autokrat-shërbyes”.

Përmes ndihmës dhe mbështetjes së vullnetit të perëndisë, perandori bizantin arriti suksesin, kështu që ai tani duhej të ishte “mik i Fjalës dhe i nënshtroar ndaj perëndisë”. Ai ishte i detyruar t’i nënshtrohej perandorit suprem – perëndisë. Në krishterim lloji eshatologjik nënkupton se sipas nevojës perandori mund të ishte regjenti i përkohshëm i perëndisë në tokë deri në rikthimin e mbretit qiellor. Duke iu njohur kjo kompetencë, parashihej që perandori të ishte mbizotërues i nënshtetasve të tij, duke i mbështetur ata në familjarizimin me perëndinë, duke i sunduar ata sipas shembullit të mbretit qiellor në mbretëritë e tokës dhe duke shtuar forcën për të plotësuar detyrat e imponuara nga vetë perëndia. Paralelisht me këto domethënie, pikëpamjet kozmopolite romake, sipas së cilave perandori është “më i miri”, vazhduan të ekzistonin. Në këndvështrimet e periudhës së principatës, ai është i zgjedhuri i popullit dhe kryesisht nga “njerëzit e armatosur”, që nënkupton ushtrinë. Duke pasur parasysh të cekurat më lart, përfundimisht mund të deklarojmë se sundimi i Konstantinit paraqet një tranzicion nga epoka antike në atë mesjetare në historinë e Perandorisë Romake dhe nëse disa nga elementet e Perandorisë së vjetër Romake janë braktisur, prapëseprapë, epoka e Konstantinit paraqet fillimin e një epoke të re mesjetare në histori.²⁰ Nga tri elementet (tradita antike, krishterimi dhe barbarizmi), marrëdhëniet reciproke të së cilave apo ndryshimet e mëvonshme vërtetuan historinë antike dhe mesjetare të popujve perëndimorë, tradita antike e Bizantit jo vetëm se u zhduk, por në një farë mënyre edhe iu nënshtroa barbarizmit dhe krishterimit, duke u transformuar përmes ndikimit të pikëpamjeve që i posedonin ata.²¹

Koncepti i sundimitarit ideal, shpëtimtarit të Perandorisë, është “utopia e fundit e Botës Antike”. Në Bizant ky koncept është zhvilluar dhe prezantuar në formën e një sundimtari të vetëm - “perandori”, i cili e kishte pozitën më të lartë kundrejt gjithë sundimtarëve tjerë. Besnikëria e shtetasve bizan-

¹⁹ Ibid., 20.

²⁰ Për më tepër informacione lidhur me tranzicionin nga epoka antike në atë mesjetare, shih: A. Atanasovski, Преодото дантичката консредно вековната римска историја (A. Atanasovski, Transition from Ancient to Medieval Roman History) - 36. Транзициите во историјата и културата (Appendices from the International Conference held in Skopje on 30-31 October 2006, in collaboration with the Ethnographic Institute with a museum at the Bulgarian Academy of Science). ИНИ Скопје 2008, 51-62.

²¹ Мутафчиев, П., Изток и Запад в европјетското средновековие. Софија 1993, 130-131.

tinë drejt përjashtimit të çdo atributi për perandorin bizantin si dhe konfliktet e vazhdueshme me sundimtarët tjerë që tentonin të fitonin tituj, një *ipsoiure* tipike e një perandori bizantin, nuk duhet të pranohet si një këmbëngulje e kotë për t'i ringjallur traditat e vdekura, të tilla sikurse mbrojtja e një ideje që shpreh thelbin e historisë mijëvjeçare të Bizantit.²² Këtu qëndron arsyeja që koncepti i perandorisë është ngatërruar me të ashtuquajturën ide romake, kurse Kostandinopoja është një Romë e re, pavarësisht faktit se emri mbështetet në mendimin e shfaqur publik që Konstantini i Madh e quajti atë kryeqytet të Romës së re.

Një karakteristikë e rëndësishme e idesë romake, nga njëra anë, është jetëgjatësia, që do të thotë se Roma është një qytet i përjetshëm (*urbs aeterna*)²³ dhe nga ana tjetër, ishte një ripërtëritje konstante. Duke e emëruar Kostandinopojën si një kryeqytet shtetëror, e jo Romën, qyteti i Konstantinit u shndërrua në një qytet perandorak²⁴ dhe mënyrë natyrale i përvetësoi edhe karakteristikat e Romës së vjetër – përjetësinë dhe ripërtëritjen (*aeternitas and renovatio*).²⁵ Në këtë mënyrë, Perandoria Romake fitoi një domethënie mistike për besimtarët e vërtetë. Nga ky vend buroi shprehja Romei, që ka të bëjë me banorët e Perandorisë Romake (Rumania).

Shprehja “Rumania”, “Ρωμανία”, “Ρωμανεία”²⁶, si një koncept gjeografik dhe politik lidhur me “tokat e banuara nga Romei”, u paraqit në shekullin IV.²⁷ Kuptimi etnik i shprehjes përfshiu popujt që banuan në tokat e Perandorisë Romake të Lindjes pavarësisht përkatësisë së tyre fisnore. Gjatë gjithë periudhës, qysh prej ndërtimit të perandorisë, bizantinët e quajtën veten si “romei”, duke i atribuuar këtij emrin një kuptim sektar e politik.

Duke i sqaruar pohimet e perandorit gjerman Otto I (936-973), peshkopi deklaroi se e drejta për ta quajtur veten “romakë” i përket banorëve të Romës dhe të Italisë. Në emër të tyre, bizantinët dëshmuuan se ata ishin pinjollë të senatorëve të migruar gjatë epokës së Konstantinit I. Ata ishin romakë dhe luftëtarë të shquar, derisa banorët aktualë të Romës ishin furrтарë,

²² Караянопулос, Й. Е., Политическата теория на Византийците, София 1992, 16.

²³ “Romulu saeternaenondum forma veratur bismoenia...” F. Dölger, Rom in der Gedanken welt der Byzantiner. – Zeitschr. f. Kirchengesch, 56, 1937, p. 71, 72.

²⁴ Κωνσταντίνος Πορφυρογέννητος. Περιθεμάτων. 1/84.2/: „... ‘επει και πόλις, εστι βασιλεύουσα τούτεκόσμου παντός ύπερέχουσα.’”

²⁵ Караянопулос, Й. Е., Политическата теория, 16.

²⁶ Amantos, K. Ρωμανία, ‘Ελληνικά, 6, 1969, 231-235.

²⁷ Tapkova-Zaimova, V., L’idèe byzantine de l’unitè dumonde et l’état bulgare. AIESEE, III, 1969, 291; Brehier, L., Les institutions de l’Empire Byzantin. Paris, 1949, 122.

të pagdhendur dhe skllever.²⁸ Sipas kësaj, përmes një marrëveshjeje me banorët e Romës dhe Italisë, bizantinët e kishin të drejtën ta quanin veten romei. Kjo e drejtë reflektohej mbi titullin e sundimtarit të tyre si dhe të nominimit të vendit të tyre si Imperiumromanum.

Çfarë ishte ideologjia e organizimit të famshëm, afatgjatë dhe vetë-restaurues të shtetit bizantin? Duhet të ceket se ajo çfarë ne quajmë sot Perandori Bizantine, - bizantinët vetveten e kanë konsideruar si pasues të drejtpërdrejtë të Perandorisë Romake. Këta të fundit, veten e quanin qytetarë të shtetit të njëjtë dhe përmes këtij fakti shpjegohet edhe tendenca e perandorëve bizantinë për ta trajtuar pushtetin e tyre si një trashëgimi nga perandorët e vjetër romakë. Në shekullin VI, perandori Justinian, e zhvilloi këtë pozitë duke shkruar një novelë lidhur me “Cezarin e mëparshëm” i cili i dha një “fillim të devotshëm të sundimit tonë autokratik”.²⁹

Perandoria Romake, në bazë të përfaqësimeve historike bizantine, nuk ishte ajo e vjetra, e mbështjellë me antikitet dhe mëkate, por ishte një shtet i ri në të cilin krishterimi dhe studimet mbi të kishin krijuar një përmbajtje dhe trend të ri spiritual.³⁰

Në njëfarë mënyre, të dhënë pas magjepsjes dhe ngazëllimit, provedienca e perëndisë i përcaktoi urdhrat botërorë dhe në këtë mënyrë perandoria u transformua në një “fqinj të zgjedhur” për përhapjen e fjalës së krishterë dhe të shpëtimit të njerëzimit. Universi kishte qenë i unifikuar qysh prej epokës së Oktavian Augustit. Me fjalë tjera aty ishte themeluar një komunitet i përgjithshëm njerëzor ku kishte lindur perëndia-njeri dhe ku studimet mbi të do të përhapeshin. Ekzistenca e këtij komuniteti është mundësuar përmes një gjuhe që ishte e kuptueshme për secilin njeri. Kjo kishte lehtësuar përhapjen e shpejtë të krishterimit.³¹

Kjo vepër e urtë e provediencës së perëndisë filloi të rishikohet gjatë epokës së Konstantinit të Madh.³² Që nga atëherë, njerëzimi kishte vështruar se si urdhrat e ofruara nga providenca e Zotit ishin bërë realitet – Perandoria e re Romake ishte themeluar; aty mbizotëronte besimi i krishterë, ligji i krishterë, trashëgimia shpirtërore e helenizmit, ligji dhe organizimi shtetëror

²⁸ Liutprandvon Cremona, dieWerke Hanover und Leipzig 1915, 202.

²⁹ Novellae Justiniani (R. Schoell; G. Kroll); 30, pr . -a. 534.

³⁰ Heisenberg, A., Staat und Gesellschaft des byzantinischen Reiches. Leipzig-Berlin, 1923, 364.

³¹ Peterson, E., Der Monotheis musul politisches problem. Leipzig, 1935, 66; 81.

³² Ευσεβιος, Βίος II, 19,(48.13 I.Heikel).

romak.³³ Perandoria e re kishte për detyrë që t’i spastronte barbarët, ta ruante paqen, të vendoste një drejtësi të përgjithshme dhe unitetin e dogmës, ta përhapte krishterimin tek barbarët me qëllim të krijimit të “një kopeje me një bari të vetëm”.³⁴ Ky ishte këndvështrimi i ri i krishterë-romak mbi botën, i cili, në ndërkohë, do të ofrojë një bazë ligjore për gjitha pretendimet e Perandorisë lidhur me sundimtarin e botës.³⁵ Shkalla në të cilën bizantinët pajtoheshin me të drejtën e jashtëzakonshme për titullin perandorak (Perandor Romak) dëshmohej nga faktet kur në vitin 800 mbreti francez - Charlemagne ishte kurorëzuar si Perandor “Romak”, ndërsa ata (bizantinët) me këmbëngulje refuzuan ta njohin këtë titull, derisa më 812 realiteti i hidhur i detyroi të tërhiqeshin. Ata e quajtën atë vetëm si “Perandor”, e jo “Perandor Romak”. Sipas pretendimit të tyre, ekzistonte vetëm një perandor dhe ai mbetej një “Perandor i vërtetë Romak” dhe ky ishte perandori që sundonte në Kostandinopojë.³⁶

Duke i njohur parimet e kishës së krishtere, perandori Konstantini i Madh (306-337) mbajti një qëndrim që do të shndërrohej në parimin drejtues të politikës së tij: “Një shtet – një kishë”. Mosbindja ndaj urdhrave të perandorit, paraqitur si një sanksionim religjioz, ishte cilësuar si “shqetësim për urdhrat e Zotit” si dhe një mos përkulje ndaj “Krishtit - mbret qiellor”. Në këtë mënyrë kriminelët u shpallën heretikë kurse heretikët u shpallën kriminelë.³⁷

Me anë të idesë për një studim të vetëm e të vërtetë religjioz, kisha pashmangshëm u bë një predikuese e tezës politike lidhur me mbizotërimin botëror të Perandorisë si dhe një lidhje e pandashme e botës dhe fuqisë shpirtërore. Këtu kemi dy fuqi: priftërinë dhe perandorinë; njërës prej tyre krijuesi ia besoi kujdesin ndaj shpirtit kurse tjetrës – udhëheqjen ndaj trupit njerëzor, kështu që asnjëri prej tyre të mos kishte humbje dhe të dyja të ru-

³³ Dölger, F., *Bulgarischeszartum und byzantinischeskaisertum*. - In: *Byzanz und dieeuropäischestaatenwelb*. Ettl, 1953, 141.

³⁴ Sipas Ungjillit të Gjonit (10:16) KJV, “Dhe delet tjera që kam, të cilat nuk janë të këtij lloji: edhe ato duhet t’i sjell, dhe ato duhet ta dëgjojnë zërin tim; dhe aty do të ketë një lloj dhe një bari” – HolyLetter (The Bible), Skopje, 1990, New Testament, p. 119.

³⁵ Караянопулос, Ы. Е., *Политическатагеория*, 12.

³⁶ Shih: I. Καρραγιαννόπουλος, *Ιστορία*, T. II, 185; *AnnalesEinhardi*. - In: *Monumenta Germaniae Historica. Auctores Antiquissimi*, I, 199: “more suo, idest Graecalingua, laudeseidixerunt, Imperatoremeum et Basileumappellantes”; MGH, *Epistulae Carolinaevi*, VII, 386.37: “... nemine mappellan dumbasilea nisi eum, quem in urbe Constantinopolitana imperii teneregubernaculaecontigisset”. See: Острогорски, Г., *ИсторияВизантије*, 190; 202.

³⁷ Бакалов, Г., *Византия*, 334.

heshin të padëmtuara.³⁸ Perandori është anëtar i kishës, kurse patriku, sikurse edhe kleri i lartë, ishin qytetarë të shtetit. Kohëve të fundit disa herë ishin detyruar ta duronin “zgjedhën e fuqisë botërore”, pavarësisht gjitha marrëveshjeve mbi barazinë.

Përktheu nga gjuha angleze: Prof.as.dr. Armend Mehmeti

³⁸ ЛевДякон, История. Подред. на Г. Г. Литаврин, Москва 1988, 55.